



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Halil Thaqi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Sami Ahmeti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbil Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL	Datë: 10.02.2026 VI- 020-78
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Kryetarit të Komunës	Krijat
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Martin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i Ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin nr. 01-060-01-2989-26, për aprovimin e propozim vendimit nr. 02-020-01-38434-25, të datës 22.12.2025, për shpalljen – publikimin në faqen zyrtare të Komunës të listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës për dhënie në shfrytëzim dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prej 15-99 vite për vitin vijues 2026.

I miratuar më datë: 29.01.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.02.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të Komunës.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Obiliqit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2026, ka miratuar vendimin nr. 01-060-01-2989-25, për aprovimin e propozim vendimit nr. 02-020-01-38434-25, të datës 22.12.2025, për shpalljen – publikimin në faqen zyrtare të Komunës të listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës për dhënien në shfrytëzim dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15-99 vite për vitin vijues 2026.

MAPL, konstaton se akti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit, është bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2, shkronja d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, po ashtu bazuar në kërkesën për rishqyrtim nga MAPL, nr. VI-020- 3/9 të datës 26.01.2026.

Vendimi është miratuar me 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Halil Thaqi, gradonačelnik opštine Obilić Sami Ahmeti, predsedavajuća Skupštine opštine Obilić
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a
Od:	Erbil Hetemi, rukovodioc Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS
Odgovorni službenici:	
1. Službenik za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, Rukovodilac Odeljenja za pregled zakonitosti akata opštinskih skupština i predsednika opštine
2. Službenik za izradu pravne ocene	Martin Shala, Viši službenik za pregled zakonitosti akata opštine
Predmet:	Potvrda zakonitosti
Vrsta akta:	Odluka

Poštovani/a gradonačelnice,
Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluku br. 01-060-01-2989-26, o odobravanju predloga odluke br. 02-020-01-38434-25, od dana 22.12.2025. godine, o proglašenju – objavljivanju na zvaničnoj internet stranici Opštine opšte liste nepokretne imovine Opštine za davanje na korišćenje i posebne liste nepokretne imovine Opštine koja se planira dati na dugoročno korišćenje u trajanju od 15 do 99 godina za narednu 2026. godinu.

Usvojena dana, 29.01.2026.god

Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 02.02.2026.god

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon pregleda sadržaja opštinskog akta kao što je gore navedeno, ocenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama važećeg zakonodavstva, dok je sadržaj akta, kao i obaveze prema drugim stranama, odgovornost opštine.

Obrazloženje

Skupština Opštine Obilić je na sednici održanoj dana 29.01.2026. godine usvojila Odluku br. 01-060-01-2989-25, o odobravanju predloga odluke br. 02-020-01-38434-25, od dana 22.12.2025. godine, o proglašenju – objavljivanju na zvaničnoj internet stranici Opštine opšte liste nepokretne imovine Opštine za davanje na korišćenje i posebne liste nepokretne imovine Opštine koja se planira dati na dugoročno korišćenje u trajanju od 15 do 99 godina za narednu 2026. godinu.

MAPL konstatuje da je akt usvojen od strane Skupštine Opštine Obilić zasnovan na članu 12, stav 12.2, tačka d) Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 13 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, kao i na zahtevu za ponovno razmatranje MAPL-a, br. VI-020-3/9 od dana 26.01.2026. godine.

Odluka je usvojena sa 21 glasom za, 0 protiv i 0 uzdržanih.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za sva dodatna pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.